



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:164859
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05480802

C.nr.1152/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – **Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil**, gjyqtari Baki Shigjeqi, me bashkëpunëtoren profesionale H.D. duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosova e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Kompania “D.C. Agency SH.P.K”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj juristi V.N. nga Prishtina, kundër të paditurit B.B. me numër personal me vendbanim në Prizren për shkak të rimbursimit të dëmit material dhe jomaterial, vlera e kontestit katërmijegjashtëqindënëntëdhjetepesë euro (4,695.00 €), pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses, e në mungesë të palës së paditur, me datë 20.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses B.K.S. me seli në Prishtinë, ashtu që **DETYROHET** i padituri B.B. nga Prizreni, që në emër të rimbursimit të dëmit material dhe jomaterial të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 25.09.2017, në Prizren, t’i paguaj paditëses shumë **prej tremijegjashtëqindetëdhjetegjashtë euro (3,686.00 €)**, me kamat ligjore sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste, mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e paraqitjes së padis (31.07.2019), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
- II. **REFUZOHET e pabazuar** kërkesëpadia e paditëses B.K.S. me seli në Prishtinë, përtej shumë së aprovuar si në diapozitivin nën I, e kërkuar në emër të rimbursimit të dëmit material dhe jomaterial, për aksidentin e datës 25.09.2017 në Prizren, dhe atë kërkesa në lartësi **njëmijëntë euro (1,009.00 €)**.
- III. **DETYROHET** i padituri B.B. nga Prizreni, që paditëses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej **njëqind euro (100.00 €)**, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Ar sy e t i m

I.Pretendimet e palëve ndërgjyqjësë.

Shqyrtimi kryesor është mbajtur në mungesë të paditurit B.B. nga Prizreni, konformë nenit 423 par.4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Paditësja B.K.S. me seli në Prishtinë, më datë 31.07.2019, në Gjykatën Themelore në Prizren, ka paraqitur padi kundër të paditurit B.B. me vendbanim në rrugën në Prizren, për shkak të rimbursimit të dëmit material dhe jomaterial, vlera e kontestit 4695.00 euro. Ka theksuar se më datë 25.09.2017, rreth orës 12:00 min, në Prizren, i padituri G.B. ka shkaktuar aksidentin e komunikacionit, me automjetin e markës “FORD”, me nr. të targave DS943BL, ku deri te aksidenti ka ardhur kur automjeti “A”, të cilin e drejtonte i padituri B.B. nga pakujdesia e godet automjetin “OPEL CORSA”, në pjesën e pasme, duke i shkaktuar dëme të dëmtuarave M.M., F.T., Sh.K. dhe S.H. Gjithashtu ka theksuar se automjeti i cili ka qenë shkaktar i aksidentit në fjalë në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë pa mbulesë siguroese, konkretisht me afat të skaduar të policës siguroese. Si rezultat i këtij aksidenti paditësja B.K.S. i’ a ka kompensuar dëmin material dhe jomaterial të dëmtuarve, bazuar në Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe LMD. Ka theksua se e paditura në procedurë jashtëgjyqësore i është drejtuar të paditurit për arritjen e një marrëveshje, po e njëjta nuk ka pasur sukses, andaj ka kërkuar nga Gjykata që pas shqyrtimit gjyqësor të nxjerrë aktgjykim me të cilin do ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësës.

I autorizuari i paditësës edhe për gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se ngelim pranë padis dhe kërkesëpadisë, kundër të padituri B.B. i cili në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë pa mbulesë siguroese, konkretisht me mbulesa sigurues të skaduar, e cila nuk e ka përfshirë periudhën e shkaktimit të aksidentit. Në fund i ka propozuar Gjykatës që pas administrimit të provave të merre vendim me të cilin padinë dhe kërkesëpadinë e paditësës ta aprovojë në tërësi si të bazuar, ashtu që të obligohet i padituri që paditësës ti rimbursoj dëmin në shumën prej 4,695.00 euro, në emër të dëmit të shkaktuar ne aksidentin e trafikut, si dhe në emër të shpenzimeve procedural, taksës gjyqësorë shumën prej 100 euro.

I padituri nuk ka paraqitur përgjigje në padi edhe pse e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi. Gjykata me datë 20.02.2024, ka caktuar seancën përgatitore, në të cilën e ka ftuar të paditurin, por se ftesa nuk ka mundur ti dorëzohet, për shkak të faktit se i padituri është i panjohur në këtë adresë-adresa e pasaktë. Pasi që i padituri gjatë zhvillimit të procedurës e ka ndërruar adresën përmes të cilës njëherë Gjykata ka komunikuar me të, dhe nuk e ka njoftuar gjykatën për një gjë të tillë, gjykata në kuptim të nenit 116 par.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ka vendosur që komunikimin me të paditurin të bëhet përmes Tabelës së Shpalljeve të kësaj Gjykate.

2. Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: raportin e aksidentit me nr. 2017-GR-0789, të dt.25.09.2017; Ujdinë Jashtëgjyqësore me nr.1473/17, të dt.24.11.2017, e lidhur mes paditëses Byroja Kosova e Sigurimit dhe të dëmtuarës M.M. urdhër transferin bankar të dt.30.11.2017; Ujdinë Jashtëgjyqësore të dt.14.09.2018, e lidhur mes paditëses Byroja Kosova e Sigurimit dhe përfaqësuesit të të dëmtuarës Sh.K., E.Q. urdhër transferin bankar të dt. 18.09.2018; Ujdinë Jashtëgjyqësore të dt.14.09.2018, e lidhur mes paditëses Byroja Kosova e Sigurimit dhe përfaqësuesit të të dëmtuarës Familjes nga Suhareka, E.Q. urdhër transferin bankar të dt.18.09.2018 dhe Parashtresë së datës 05.06.2018, të paraqitur nga përfaqësuesi i të dëmtuarës S.I., E.Q. për shqyrtimin e ankesës me nr. FK-1575/2017.

Nga leximi i raportit të policisë me nr.2017-GR-0789, të datës 25.09.2017, gjykata vërtetoi faktin se më datë 25.09.2017, rreth orës 12:00 min, në rrugën “Ismail Kryeziu”, në Prizren, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, ndërmjet automjeti A, të markës “FORD FIESTA”, me nr. të targave të cilin e drejtonte paditësi B.B. dhe automjeti B, i markës “OPEL CORSA” me targa të regjistrimit 04-647-FD, të cilën e drejtonte e dëmtuara M.M.. Deri tek aksidenti kishte ardhur kur drejtuesi i veturës A, deri sa ishte duke lëvizur në drejtimi të lagjes Arbana, në shiritin e majtë të rrugës, me të arritur afër lokalit “.....”, për shkak të mos mbajtjes së distancës së sigurisë, me pjesën e përparme e godet në pjesë e pasme automjetin e drejtuesit B, i cili në momentin e aksidentit e kishte zvogëluar shpejtësinë e lëvizjes para pengesës në rrugë. Si pasojë e këtij aksidentit vozitësja e automjetit B, dhe katër udhëtarët pësojnë lëndime të përshkuar si në raportet mjekësore, ndërsa në të dy automjetet shkaktohen dëme materiale. Po ashtu nga raporti policor gjykata vërtetoi faktin se në momentin e shkakimit të aksidentit, i padituri ka pasur mbulesë siguroese pranë të paditurës BKS deri me datë 12.09.2017, dhe se nuk ka poseduar patentshofer, që do të thotë se në momentin e aksidentit, konkretisht me datën 25.09.2017, automjeti në fjalë nuk ka pasur mbulesë siguroese, respektivisht ka qenë me policë të sigurimit të skaduar, dhe se nuk ka pasur të drejtën e drejtimit të automjetit.

Nga Ujdia Jashtëgjyqësore me nr.1473/17, të dt.24.11.2017, Gjykata vërtetoi faktin se është arritur marrëveshja jashtëgjyqësore mes këtu paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit dhe përfaqësueses së të dëmtuarës M.M. nga Prizreni, E.Q. nga Prizreni, lidhur me dëmin material të pësuar nga e dëmtuara në automjet, në aksidentin e dt.25.09.2017, në Prizren. Sipas kësaj marrëveshje, në emër të zhdëmtimit të dëmit material në automjet të pësuar në aksidentin e lartcekur, të dëmtuarës M.M. do ti paguhet shuma prej 530.00 euro.

Nga urdhër transferi bankar i dt.30.11.2017, i lëshuar nga paditësja Byroja Kosovare e Sigurisë, Gjykata vërtetoi faktin se është bërë transferimi i shumës prej 530.00 euro, në emër të zhdëmtimit të dëmit material nga këtu paditësja, tek E.Q. përfaqësuesi i të dëmtuarës M.M.

Nga Ujdia Jashtëgjyqësore e datës 14.09.2018, Gjykata vërtetoi faktin se është arritur marrëveshja jashtëgjyqësore mes këtu paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit dhe përfaqësuesit së të dëmtuarës Sh.K. nga Prizreni, E.Q. nga Prizreni, lidhur me dëmin material dhe jomaterial të pësuar nga e dëmtuara në aksidentin e dt.25.09.2017, në Prizren. Sipas kësaj

marrëveshje, në emër të zhdëmtimit të dëmit material dhe jomaterial të pësuar në aksidentin e lartcekur, të dëmtuarës Sh.K. do ti paguhet shuma prej 423.00 euro.

Nga urdhër transferi bankar i dt.18.09.2018, i lëshuar nga paditësja Byroja Kosovare e Sigurisë, Gjykata vërtetoi faktin se është bërë transferimi i shumës prej 423.00 euro, në emër të zhdëmtimit të dëmit material dhe jomaterial nga këtu paditësja, tek E.Q. përfaqësuesi i të dëmtuarës Sh.K.

Nga Ujdia Jashtëgjyqësore e datës 14.09.2018, Gjykata vërtetoi faktin se është arritur marrëveshja jashtëgjyqësore mes këtu paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit dhe përfaqësuesit së të dëmtuarve familjes nga Suhareka, E.Q. nga Prizreni, lidhur me dëmin material dhe jomaterial të pësuar nga e dëmtuara në aksidentin e dt.25.09.2017, në Prizren. Sipas kësaj marrëveshje, në emër të zhdëmtimit të dëmit material dhe jomaterial të pësuar në aksidentin e lartcekur, të dëmtuarës familja (dhe atë për të dëmtuarin A.T. shumën prej 2300 euro dhe për të dëmtuarën Zh.T. shumën prej 424 euro), në total do ti paguhet shuma prej 2724.00 euro.

Nga urdhër transferi bankar i dt.18.09.2018, i lëshuar nga paditësja Byroja Kosovare e Sigurisë, Gjykata vërtetoi faktin se është bërë transferimi i shumës prej 423.00 euro, në emër të zhdëmtimit të dëmit material dhe jomaterial nga këtu paditësja, tek E.Q. përfaqësuesi i të dëmtuarës Sh.K.

Nga parashtresa e datës 05.06.2018, gjykata vërtetoi faktin se i autorizuar i i të dëmtuarës S. H. E.Q. nga Prizreni, i është drejtuar paditëses BKS-, me parashtres për rishqyrtimin e ankesës lidhur me lëndën me nr. FK-1575/2017, e cila ishte duke u shqyrtuar në procedurë administrative për zhdëmtimin e të dëmtuarës S.H. për lëndimet e pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 25.09.2017.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të administruara, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar.

3. Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës.

Me nenin 18 par. 1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Ligji Nr.04/L-018, dëshmëpërblimi nga përdorimi i mjetit të pasiguruar është paraparë se: *“Personit të dëmtuar të cilit është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësisë, ka të drejtën të kërkojë dëshmëpërblimin e dëmit nga byroja”,* me par. 4 të këtij neni është paraparë *“byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*. Po ashtu me nenin 14 par. 1 të po këtij ligji thuhet *“I siguruari e humbë mbulesën siguruuese, kur: 1.2. drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimeve të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimit”,* ndërsa

në par. 3 thotë se *“Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese”*, andaj është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pra nga të gjitha këto prova të administruara është vërtetuar fakti se shkaktari i dëmit material është vetëm i padituri, për më tepër i njëjti nuk ishte i siguruar për dëme nga autopërgjegjësia, përkatësisht polisen e sigurimit e ka pasur me afat të skaduar dhe automjetin e ka drejtuar pa patentshofer, si rrjedhojë e kësaj Byroja Kosovare e Sigurimeve ka bërë dëmshpërblimin e dëmeve të dëmtuarve, dhe nga këto arsye Gjykata mori këtë qëndrim duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitën e nenit 960 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr. 04/L-077 është paraparë që *“Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin”*

Pra duke pasur parasysh të gjitha këto prova të administruara si dhe fakte të vërtetuara, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga arsyet se nuk ishte kontestuese se i padituri, B.B. nga Prizreni, me dt.25.09.2017, me automjetin “FORD FIESTA”, gjersa ishte duke lëvizur në rrugën “Ismail Kryeziu”, në drejtim të lagjes Arbana, duke mos e mbajtur distancën e mjaftueshme në mes automjeteve, duke mos e vërejtur se automjeti i të dëmtuarës M.M. është ndalur para pengesave në rrugë, nga pakujdesia dhe në pamundësi për tu ndalur, e godet me pjesën e përparme, në pjesën e pasme automjetin e markës “OPEL CORSA”, pronë e të dëmtuarës M.M. Përveç dëmeve materiale të shkaktuar në të dyja automjete, lëndime trupore kanë pësuar edhe drejtuesja e automjetit “Opel Corsa”, M.M., A.T., Gj.T., Sh.K. dhe S.H.

Nga ujdite jashtëgjyqësorë, gjykata e vërtetoj faktin se e paditësja BKS e ka bërë zhdëmtimin e dëmit të dëmtuarve M.M., A.T., Gj.T., Sh.K. dhe S.H. për dëmin material dhe jo material, të pësuar në aksidentin e datës 25.09.2017, të shkaktuar nga i padituri, i cili në momentin e shkaktimit të aksidentit ka humbur mbulesë siguruese– pasi që ka drejtuar mjetin motorik pa mbulesë siguruese dhe pa patentshofer. Andaj si rrjedhojë e kësaj, i padituri G.B. si shkaktar i aksidentit, bazuar në ligjin për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, për automjetet e pasiguruara dhe të drejtuar pa patentshofer, për dëmin e shkaktuar të dëmtuarve dhe ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve, ka për obligim që të njëjtën shumë t’ia rimbursojë këtu paditëses. Bazuar në këto fakte, Gjykata ka konstatuar se në rastin konkret i padituri duhet të obligohet që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit material dhe jomaterial, t’i paguajë shumën prej 3686.00 euro, shumë kjo e vërtetuar në bazë të urdhrave të transfereve bankare të bëra nga llogaria e paditëse- BKS, tek i autorizuari i palëve të dëmtuara, E.Q. si dhe ujdive jashtëgjyqësore të arritura në mesë të paditëses dhe të autorizuarit të palëve të dëmtuar (të cilat gjinden në shkresat e lëndës).

Ndër të tjera theksohet se këtu i padituri përkundër mundësisë së dhënë nga Gjykata nuk është deklaruar rreth kësaj çështje, pasi që i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje në padi dhe nuk është paraqitur në gjykatë edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt.

Nga dispozitat e lartcekura, e duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, Gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për regresimin e dëmit paditëses, pasi që paditësja i'a ka kompensuar të dëmtuarve dëmin e shkaktuar nga ana e të paditurit. Andaj, nga të lartcekurat, u vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Lidhur me lartësinë e kompensimit, Gjykata mori për bazë shumën e kompensimit të dëmtuarve nga ujdite jashtëgjyqësore dhe urdhër transferet bankare, nga e cila u vërtetua se paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit “BKS”, i ka kompensuar të dëmtuarin dhe atë në shumë të përgjithshme prej 3686.00 €.

Për detyrimin e të paditurit për të paguar kumatën ligjore, Gjykata vendosi duke u bazuar në kërkesën e palës paditëse dhe konform nenit 378 lidhur me nenin 382 par. 1 të LMD-së.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, shumës mbi shumën e aprovuara, të vendosur si në pikën nën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata të njëjtën e refuzoi ngase gjeti se e njëjta është e pabazuar. Në nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, andaj në bazë të provave të administruara, e sidomos marrëveshjeve jashtëgjyqësore dhe urdhërtransfereve bankare, u vërtetuar se shuma e zhdëmtimit të dëmi të cilën paditësja ia ka shkaktuar të dëmtuarve është në shumë prej 3686.00 euro, e nga kjo arsyeje gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke e refuzuar pjesë tjetre të kërkesë së paditëses në lartësi prej 1,009.00 €.

Për pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata vendosi konform nenit 452 parag.1 lidhur me nenin 463.1 të LPK-së, në emër të taksën gjyqësore në shumën prej 100.00 €.

Nga të lartcekurat dhe bazuar nenin 136 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 në lidhje me nenin 18 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Ligji Nr.04/L-018, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:164859, 20.03.2024

G j y q t a r i

Baki Shigjeqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.